Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**07.12.2023**	**12.12.2023**	**2023/0968**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.12.2023, **OE "Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0968,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Eurosig" Sh.a, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunes se Prishtines dhe KPSH-se**" me nr. të prokurimit: **"616-23-5923-2-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **175,000.00 €.**

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0672 i dt:24.10.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Janë bërë shkelje në LPP;

Nenin 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Duke u bazuar ne vendimin e dates 22.11.2023 ne te cilen AK e shpall ankesen tone si te pabazuar ,duke mos e marr parasysh vendimin e ekspertit dhe vendimin e OSHP qe ankesa jone ka qene pjeserisht e bazuar dhe qe njoftimin mbi vendim te Rivlersohet ,AK ka vazhduar ne vendimin e njejte duke e shpall fitues prap kompanine Eurosig . AK ne perpilimin e specifikimeve teknike ka bere shkelje duke I vendosur specifikimet ne menyre qe ti ve ne lajthitje OE ne menyre qe kompania Eurosig te jete me cmim me te ulet pasiqe kete kontrate e ka pas ne vitin paraprak dhe I k a poseduar te gjitha informatat e nevojshme per llogaritjen e cmimeve te automjeteve. Kompania Eurosig nuk eshte bazuar ne specifikimin teknik te cilin e kemi pasur edhe ne por ka vendosur cmime ne shkelje te tarifave te aprovuara ne BQK . Me poshte gjeni faktet ne te cilat jane bere shkelje :

1.Mosrespektimi i Specifikimeve Teknike nga kompania EUROSIG Sh.a.

Shembull veturen e njejte ne te cilen I kane jep scarimet ne vendimin e komisionit te dates 22.11.2023 :

Pershkrimi I specifikave ne dosje te tenderit shembulli I rastit me tabela : 112-127-02

Pesha pa ngarkese :9600

Pesha max e lejuar :18000

Cm3 -10964

Ne qertifikaten e regjistrimit te automjetit (libreze) informatat jane si me poshte :

Pesha ,

Pesha max ngarkeses se lejuar ,

Pesha e automjetit Cm3.

Sipas scarimit ne vendimin e marr nga AK cmimi I sigurimit TPL eshte pesha max e ngarkese se lejuar (ne kete rast sipas specifikave Pesha max e lejuar 18000 duke e minusuar Pesha pa ngarkese 9600 del cmimi per peshen max te ngarkeses qe ne rastin konkret eshte 8400 –cmimi sipas tarifes 535.72 EUR)

Duke e krahasuar pershkrimin ne specifikacion na qon ne lajthitje per shkak qe ne kemi jep Cmimin duke u bazuar ne Pesha max e lejuar ne specifikacione teknike siq e potencon edhe qertifikata e regjistrimit te automjetit . Ne libreze shenimet per veture duke I krahasuar ne specifika :

Pesha ne libreze –I referohet pershkrimit ne dosje **Pesha max e lejuar**

Pesha e automjetetit ne libreze – I referohet pershkrimin ne dosje **Pesha pa ngarkese**

Ndersa **Pesha max e ngarkeses se lejuar** ne ju kemi referuar si Pesha max e lejuar ,ndersa OE Eurosig I eshte referuar si Pesha max e lejuar minus Pesha pa ngarkese ,qe nenkupton qe nuk

eshte I qarte pershkrimit te ciles ju ka referuar ne dosje te tenderit dhe eshte bere qe te arrihet cmimi me I ulet per keto automjete qe jane me peshe bartese .

Per veturen e njejte nga ana jone eshte jep cmimi ne vlere 896.80 EUR sipas Peshes max te lejuar 18000 ne dosje te tenderit .

Si deshmi ju kemi bashkangjitur nje libreze te nje automjeti me peshe bartese (e cila nuk eshte per KK Prishtina pasiqe nuk I kemi poseduar librezat jemi bazuar vetem ne specifikacione) .

Pikat ne te cilat jane bere shkeljet e njejta jane :

Pika 10,11,12,13,14,15,16,18,19,21,23,26,27,28,29,34 dhe 35

2.Përdorimi i informacionit nga BQK-ja

Autoriteti Kontraktues ka shpallur fituesin e prokurimit duke u bazuar në sqarimet e marra nga BQK-ja sipas vendimit te dt 22.11.2023 .

Ne deshmine qe na eshte dorezuar (email I bashkangjitur ne kete ankese) AK ka kerkuar nga BQK qe te ja percjell linkun e tarifave zyrtare per kompanite e sigurimit Jo-jete por nuk ka kerkuar se a jane te obliguara kompanite e Sigurimit ti respektojne tarifat te cilat jane te aprovuara nga Banka Qendrore.

Ne pergjigjen e BQK-se ne fjaline e pare ka thene : Te gjithe siguruesit Jo-Jete jane te obliguar qe ti respektojne tarifat e autopergjigjesise MTPL te aprovuara nga BQK te cilat jane te publikuara ne web faqen e BQK-se

Dmth Banka Qendrore ka scaruar qe per cdo klase te Sigurimit te autopergjigjesise tarifat duhet te vendosen ne baze te specifikimeve te automjetit.

Ankesa jone është e bazuar në disa fakte konkrete dhe shqetësime të lidhura me procesin e prokurimit dhe vendimin përfundimtar të Autoritetit Kontraktues.

Kerkojme nga OSHP qe ta shqyrtoj perseri lenden dhe ta obligoj AK qe ta shpall fitues kompanine Scardian sepse eshte I vetmi vendim I drejt duke u bazuar ne faktet e prezentuara te cilat jane te pakontestueshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni per rivleresimin e ofertave ka konstatuar se per kete aktivitet te prokurimit „Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te komunes se Prishtines dhe KPSH-se", kane ofertuar gjithsej tre OE.
OE SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. eshte e papergjegjshme , pasi qe çmimet nuk i ka dhene ne paramasen e ngarkuar ne platforme me date 07.07.2023, shto dokument te ri. Prove: Paramasa e ngarkuar ne platforme shto dokument te ri e dates 07.07.2023.

OE Kompania e Sigurimeve SCARDIAN J.S.C. eshte e pergjegjshme.por ka ofertuar me çmim me te larte me poentim, andaj edhe eshte e pasuksesshem.

Pas Vendimit te OSHP-se nr 672/23, te dates 25.10.2023, te ankeses se OE KS SCARDIAN J.S.C., per pretendimet lidhur me disa çmime te vendosura ne pozicionet :10,11,12,13,14,15,16,18,19,21,23,26,27,28,29,34 dhe 35, ne paramase, nuk perkojne me tarifat e BQK-se, te ofertes se OE Grup i Operatorëve Ekonomik KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.; Autocon SH.P.K.. komisioni per rivleresim te ofertave me date 01.11.2023, ka kerkuar sqarime zyrtare nga BQK-ja permes e-mailit zyrtar lidhur me tarifat per sigurimin e automjeteve TPL, dhe kemi pranuar sqarimet nga BQK-ja me date 01.11.2023, ku citojme : Të gjithë siguruesit Jo-Jete janë te obliguar ti respektojnë tarifat e autopërgjegjësisë MTPL te aprovuara nga BQK-ja te cilat gjithashtu janë të publikuara ne web faqen e BQK-se, respektivisht në linkun e BQK-se; https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fbqk-kos.org%2Frepository%2Fdocs%2F2019%2FTarifat-15112019.xlsx&wdOrigin=BROWSELINK.Ku komisioni per rivleresim te ofertave ka verifikuar perms ketij webliku, tarifat e çmimeve per keto pozicione te pretenduara se nuk perkojne me tarifat e BQK-se, mirepo, pas ketij verifikimi eshte vertetuar se tarifat e çmimeve per sigurimin e automjeteve TPL,te dhena ne oferte per sigurimin e automjeteve TPL, nga OE Grup i Operatorëve Ekonomik KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.; Autocon SH.P.K. jane ne perputhje me çmimet e vendosura per tarifa te sigurimeve TPL, te BQK-se e qe jane unike per te gjitha kompanite e sigurimeve ne Kosove.
Andaj, komisioni REKOMANDON per dhenie te kontrates Grup i Operatorëve Ekonomik KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.; Autocon SH.P.K., me çmim me te lire me poentim prej 17,739.04.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Kërkesë për sqarim pranë BQK, me e mail data 11.12.2023,

Ftesë në takim, anëtarin e komisionit nga AK data 15.12.2023,

Kërkesë për sqarim pranë BKS data 15.12.2023,

Kërkesa me email pranë AK-së, për librezat e automjeteve, data 18.12.2023.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.**

Sqarim hyrës:

Aktiviteti i prokurimit, me titull: "**Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve te Komunes se Prishtines dhe KPSH-se**" me nr. të prokurimit: **"616-23-5923-2-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 12.06.2023, Hapja e ofertave është bërë me datë 14.08.2023, përmes procedurës së hapur, kontratë Shërbim.

Aktiviteti në fjalë është rivlerësuar me vendim të OSHP-së PSH.nr: 2023/0672, dhe si rrjedhojë me datë 07.11.2023 gjatë procedurës së rivlerësimit, AK publikon njoftimin B58 me të cilin rekomandon të njëjtin OE Eurosig Sh.a, ndërsa OE ankuesin e shpallë të pa suksesshëm.

Tutje, OE ankuesi pretendon *se prap AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat, për arsye se tek paramasa ka vendosur emërtimin ndryshe nga librezat, duke na vënë në lajthitje neve si OE.*

Ekspertja shqyrtuese duke u gjendur në një situatë të tillë, meqenëse krahas tarifave të BQK-së ka dallime në çmimet e ofuara nga OE i rekomanduar, fillimisht kërkon sqarim me datë 11.12.2023 me email në BQK-Departmenti i Sigurimeve, duke ju kërkuar që të sqarojnë se si bëhet llogaritja e tarifës krahasuar me tarifat e dhëna nga kompanitë e sigurimeve Eurosig sh.a dhe Scardian JSC në BQK.

BQK me datë 13.12.2023 ka sqaruar se citat:" ***Kamionët që ngarkohen llogariten për ngarkesën që mund të bartin, prandaj pasi në tarifat e BQK-së nuk është e specifikuar për kamionë special (në këtë rast zjarrfikës), duhet të llogaritet duke ia zbritur peshën pa ngarkesë, pra të tariforet vetëm për ngarkesën që bartë***"

Ekspertja shqyrtuese pas verifikimit të tarifave të BQK-së, duke i krahasuar me ofertën e OE të rekomanduar vetëm pozicionet/pikat e atakuara nga OE ankues (10,11,12,13,14,15,16,18,19,21,23,26,27,28,29,34 dhe 35) konsideron se, OE i rekomanduar në pikat 10, 21,23,27 ka dallim tarifa me ofertën, pra ekspertja shqyrtuese ka kalkuluar sipas sqarimit të BQK-së, dmth kamionët special në rastin konkret kamionët e zjarrëfikësve, janë verifikuar duke ia zbritur peshën e ngakuar nga pesha maksimale, mirëpo siq sqaruam edhe më lartë pikat e lartëpërmenduar, nuk përkojnë çmimet në ofertë me tarifat e BQK-së dhe krahasimi me paramasë të AK-së, andaj si e tillë **pretendimi I OE ankues gjendet I bazuar.**

Vlenë të theksohet se, gjatë analizimit të çmimores për pikat në pretendim, kemi ftuar në takim gjithashtu edhe një anëtar të komisionit-AK, duke kërkuar sqarime se nëse ka ndonjë shpjegim lidhur me çmimet e ofruara nga OE I rekomanduar, ku ky I fundit pas verifikimit të pikave, konkludojmë s'bashku, se pikat 10, 21, 23, 27 kanë dallime në çmimore me tarifa të BQK-së. Për të cilat pika meqë kishim dilema, atëherë kam parashtruar e-mail pranë Byros Kosovare të Sigurimeve(BKS), duke kërkuar nga të njëjtit që të na qartësojnë këto çmime.

BKS ka sqaruar se çmimoren dhe tarifat për këto pika të kontestuara duhet ti referohemi librezave, sepse në paramasën e dërguar nuk mundet të verifikohet.

Tutje, kam kërkuar nga AK që të na bashkangjiten librezat, me qëllim që ti krahasojmë se a përputhen të dhënat në paramasë me librezat, dhe si e tillë vërejmë se ka mos përputhje.

Si përfundim, pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet e OE ankues, sqarimet nga BQK, sqarimet nga BSK, bazuar në argumente dhe fakte, konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet conform nenit 43.5 pika pika b."*asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm",* për faktin se, ne pasi kemi kërkuar nga AK që për pikat kontestuese të na sigurohen librezat, aty kemi vërejtur se, AK ka vendosur një paramasë (të dhëna) të cilat nuk përkojnë plotësisht me të dhënat në librezat fizike të automjeteve, i cili informacion pastaj ndryshon çmimin e ofertuesve në ofertat e tyre, dhe si e tillë rezulton se nuk ka oferta të përgjegjshme.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.**

Blerina Huruglica